

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK-SHTATOR 2024

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1/email	01.07.2024	Informacion mbi statusin aktual të procesit të miratimit të projektit për restaurimin e Xhamisë së Plumbit, Shkodër	01.07.2024	Ne vijim te kerkeses tuaj date 01.07.2024 ne te cilen kerkoni informacion mbi statusin aktual të procesit të miratimit të projektit "Xhamia e Plumbit", Ju informojme si vijon: Këshilli Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim KKTKM) në mbledhjen e datës 21.06.2024mori Vendimin Nr. 181, me titull: Miratimin e projektit “<i>Projekti i ringritjes dhe restaurimit të minares së Xhamisë së Plumbit, Shkodër dhe rikualifikimi dhe restaurimi i zonës së mbrojtur të monumentit</i>”, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, Brenda Kufirit të Zonës Mbrojtëse të Monumentit, Bashkia Shkodër, me aplikues dhe zhvillues Kadioglu Restorasyon Ve Mimarlik Sanayi Ve Ticaret Limited Sirketi. Bashkëlidhur lutemi gjeni Vendimin e sipërcituar. Ne perfundim Ju sqarojme se te gjitha Vendimet e KKTKM, pasi zbardhen, publikohen ne faqen ëeb te IKTK dhe mund ti aksesoni ne link: IKTK Vendime 2024	E plotë	Jo
2/email	04.07.2024	1- Sa është numri i urave Monument Kulture në Shqipëri? 2- Si paraqitet gjendja e tyre nga raportet e vlerësimit në terren? Jepni të dhëna specifike për secilën prej tyre bazuar në vlerësimet tuaja të fundit; 3- Sa projekte restaurimi janë hartuar në 10 vitet e fundit për urat Monument Kulture në vend? 4- Sa prej këtyre projekteve janë zbatuar? 5- Sa është vlera e projekteve të zbatuara? 6- Sa ura Monument Kulture janë rindërtuar pas shkatërrimit të tyre nga shkaqe të ndryshme? Listojeni secilën prej tyre; 7- Sa ura Monument Kutlure janë dëmtuar në 10 vitet e fundit nga kushtet atmosferike, degradimi, ndërhyrja e njeriut apo faktorë të tjerë, që janë evidentuar në raportet tuaja?	04.07.2024	Në vijim te emalit tuaj, sqarojmë si vijon: Ne zbatim te Ligjit nr. 27/2018 "<i>Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë</i>", Neni 31, pika 1, kërkesa mund te dërgohet ne Drejtoritë Rajonale te Trashëgimisë Kulturore, për te marrë informacion mbi pasuritë kulturore, ne këtë rast për Urat, qe ato kane ne administrim. IKTK per shkak edhe te kapaciteteve te burimeve njerezore e ka te pamundur shqyrtimin e saj.	E plotë	Jo

		8- A janë depozituar pranë jush në 10 vitet e fundit ankesa nga subjekte të ndryshme, lidhur me urat monument kulturë në vend? Nëse po, na i vendosni në dispozicion. 9- Cila janë rekomandimet e lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në lidhje me urat apo monumentet e kulturës në vend për 10 vitet e fundit? Na informoni se si janë reflektuar këto rekomandime.				
3/ email	15.07.2024	Kërkesë për informacion për monumentin e kulturës, kategoria e I, regjistruar ne emrin Strati Zhupa	16.07.2024	"BANESA E STRATI ZHUPES NË FSHATIN DHËRMI", gezon statusin Monument Kulture i Kategorise se I-re, shpallur me Urdher Nr.266/1, dt.16.02.1979 nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës (Drejtoria e Kulturës) dhe ndodhet brenda Qendres Historike te fshatit Dhermi, perkatesisht ne nenazonen II. Sipas Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 5, Pika 36. a), <i>“Monument kulture i kategorisë I” është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili ruhet në tërësinë e përbërësve të tij arkitektonikë dhe teknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen.</i> Ju informojme se kjo banesë është gjithashtu subjekt i Urdhërit të Ministrit të Kulturës Nr. 297, datë 31.07.2015, “PËR SHPALLJEN E ZONAVE TË MBROJTURA TË MONUMENTEVE TË KULTURËS”, i cili citon se: Zona e mbrojtur e monumentit të kulturës konsiderohet sipërfaqja e truallit brenda kufirit të pronës në të cilën ndodhet monumenti. Thën kjo, Ligji Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 77, Pika 2 ç) përcakton se Kryhen vetëm me leje të Keshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM): gërmimi, restaurimi, përdorimi dhe çdo veprim tjetër në pasuritë kulturore, si dhe çdo ndërhyrje në truallin e vënë në mbrojtje rreth tyre. Gjithashtu referuar VENDIM Nr. 29, datë 20.12.2016 "PËR SHPALLJEN E QENDRES HISTORIKE TE FSHATIT DHERMI DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PER	E plotë	Jo

				ADMINISTRIMIN E SAJ E TE ZONES SE MBROJTUR PERRETH", Neni 10, Pika 1 e shpreh qartë se: <i>Projektet e restaurimit dhe resataurimi i monumenteve të kulturës behen nga institucione shtetërore të specializuara ose nga subjekte të licencuara për këtë qëllim. Projektet shqyrtohen ne Keshill Shkencor (sot Keshill Teknik) te Institutit te Monumenteve te kultures (sot IKTK) dhe miratohen në Keshillin Kombetar te Restaurimeve (sot Këshillin Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në vijim "KKTKM")....</i> Sa me sipër ju mund ti drejtoheni institucioneve shtetërore të specializuara apo subjekteve private të liçencuara në fushën e projektimit me liçencën përkatëse në restaurim, në mënyrë që të hartojnë dhe aplikojnë projektin e mirëmbajtjes apo te restaurimit, në sportelin unik të KKTKM-së, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Aplikimi për "Leje për ndërhyrje në Pasuri Kulturore Materiale" kryhet nëpërmjet portalit E-Albania, duke përdorur shërbimin "Leje për ndërhyrje në Monument Kulture Kategori I-re". Subjekti aplikues mund të aksesojë këtë shërbim në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/ealbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13702 për vijimin e procedurës së shqyrtimit deri në vendimmarrjen e KKTKM-së.		
4/ email	16.07.2024	Materiale arkivore në lidhje me objektet: 1. Porta e Jashtme e Banesës R. Saraçi , Monument kulture kategoria e Pare 2. Porta e Jashtme e Banesës Kurti, Monument kulture kategoria e Pare 3. Porta e Jashtme e Baneses M. Bozo, Monument Kulture Kategoria e Pare.	17.07.2024	Në vijim të kërkesës Suaj prane IKTK-së, më datë 16.07.2024, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", ju vendosim ne dispozicion bashkelidhur ne link kopje digjitale te dokumentacionit arkivor fotografik per objektin pasuri kulturore si me poshte: Porta e Jashtme e Banesës R. Saraçi , Monument kulture kategoria e Pare: https:// www.transferxl.com/download/00KQJFr4E724X Porta e Jashtme e Banesës Kurti, Monument kulture kategoria e Pare: https:// www.transferxl.com/download/08vJrdXkq3ë1jq Porta e Jashtme e Baneses M. Bozo, Monument Kulture Kategoria e Pare: https://www.transferxl.com/download/08y1CJ2c27RLT Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me	E plotë	Jo

				to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoren materialet arkivore.		
5/ email	23.07.2024	Ankese ne lidhje me projektin T.I.D Dures	30.08.2024	Në vijim të kërkesës Suaj, në lidhje me “objektin e banimit me nr. Pasurie 24/166+1-5 Zona Kadastrale 8512, me vendndodhje në qytetin e Durrësit rruga “Qemal Stafa”, Ju sqarojmë si vijon: Nga verifikimi i kartelës së pasurisë bashkëlidhur kërkesës Suaj, rezulton se objekti ndodhet brenda zonës arkeologjike “A”, të qytetit të Durrësit të miratuar me VKM nr. Nr. 786, datë 26.12.2018 “Për miratimin e zonave arkeologjike “A” dhe “B”, të qytetit të Durrësit dhe të planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”. Gjithashtu, objekti I sipërcituar është pjesë e zonës së projektit “Restaurimi dhe rikualifikimi i zonës perspektive TID në Parkun Arkeologjik Durrës”, miratuar pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore(KKTKM), me vendim Nr. 461 datë 16.09.2022. Në lidhje me kërkesën/ankesën Tuaj, sqarojmë se KKTKM, bazuar në kompetencat e përcaktuara në ligjin 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” neni 38 pika 2, si dhe VKM nr. 208 datë 10.04.2019 “Për përbërjen, mënyrën dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, trajron dhe shqyrton projektet nga pikëpamja e impaktit në trashëgiminë kulturore dhe në rastin konkret, në raport me zonën arkeologjike “A” të qytetit të Durrësit. Klasifikimi, vlerësimi dhe mënyra e trajtimit të objektit në fjalë, si dhe objekteve të tjera pjesë e zonës së projektit “TID Durrës” nuk është kompetencë e KKTKM-së. Bashkëlidhur gjeni vendimin nr. 461 datë 16.09.2022 të KKTKM-së për projektin “TID Durrës”. Vendim-nr.-461-dat e-16.09.2022-Rikalifi	E Plotë	Jo
6/ email	26.07.2024	Kërkesë për shpalljen e Xhamisë Gizavesh, Monument kulture.	15.08.2024	Ne vijim te kerkeses suaj, Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore,ne zbatim te dispozitave ligjore te Ligjit nr.	E plotë	Jo

				27/2018 "Per Trashegimine Kulturore dhe Muzete", i ka derguar shkrese Drejtorise Rajonale te Trashegimise Kulturore Korçe pasi objekti qe ju propozoni administrohet nga kjo Drejtori Rajonale per kryerjen e nje inspekimi ne terren per te verifikuar objektin qe propozohet per shpallje te interesit kulturor.. Sa me siper do te njoftoheni perseri mbi hapat qe do te ndiqen ne vijim per kete rast.		
7/email	02.08.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me: - objektet e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, duke u ndalur specifikisht në ato për restaurimin e monumenteve të kulturës (si psh për kalanë e Kaninës, kalanë e Borshit apo Muzeun Arkeologjik Korçë etj). - gjendjen në Butrint, si dhe në Berat e Gjirokastrë, duke marrë shkas edhe nga mbledhja e fundit dhe raporti i UNESCO-s.		Në vijim të kërkesës përcjellë nga ana juaj nëpërmjet postës elektronike, ju informojmë se: Projektet e ndërhyrjeve në pasuritë kulturore të cituara nga ana juaj, janë projekte të aplikuara në sistemin online E-lejet dhe janë miratuar në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore. Më specifikisht, projektet për Kalanë e Borshit dhe Kalanë e Kaninës janë në fazën e Projekt idesë, të hartuara nga Cultural Heritage eithout Borders, të cilat kanë si qëllim ndërhyrje konservuese, strukturore e gjeologjike, si edhe planet e interpretimit për përmirsimin e eksperiencës së vizitorëve. Projekti për Restaurimin e Muzeut Arkeologjik në Korçë është projekt i hartuar nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Korçë si pjesë e detyrave funksionale të DRTK Korçë. Lidhur me prononcimin në vijim të mbledhjes së fundit dhe raportit të UNESCO-s sqarojmë se raporti final është publikuar në faqen zyrtare dhe mund të aksesohet publikisht.	E plotë	Jo
8/email	13.08.2024	Kërkësë për vijim e procedurave të legalizimit	16.08.2024	Ne vijim te kerkeses tuaj lidhur me aplikimin per vijimin e procedures se legalizimit te apartamentit "Shtese ne lartesi 1 kat ne objektin ekzistues 5 kat", pallati Shallvare ndodhur ne rrugen Reshil Collaku, Tirane, ju bejme me dije se: Kerkesa per vijimin e procedurave te legalizimit me aplikues Z. eshte shqyrtuar ne mbledhjen e Keshillit Teknik te dates 19.03.2024 dhe eshte ne pritje te shqyrtimit me tej ne Keshillin Kombetar te Trashegimise Kulturore (KKTKM) per nje vendimmarje.	E plotë	Jo

				Pasi te shqyrtohet ne KKTKM, IKTk do te percjelle vendimmarrjen prane Agjencise Shteterore te Kadastres, Drejtoria Vendore Tirana Veri, si dhe vendimi do te publikohet ne faqen �eb te IKTk.		
9/ 1373 Prot	26.08.2024	K�rkes� p�r informacion- Gjuhadol Shkod�r	09.09.2024	N� vijim t� shkres�s me Nr.1373 Prot., dat� 26.08.2024, "K�rkes� p�r informacion" n� kuad�r t� tem�s s� diplom�s s� studentes s� arkitektur�s Flonja Akshija ju b�jm� me dije si me posht� vijon: Lidhur me pikat 2, 4, 5 dhe 6 t� kerkes�s n� fjal� n� Arkivin Teknik disponojm� dokumentacion teknik grafik dhe fotografik p�r nd�rtesat e rrug�s "Gjuhadol" dhe "Kol Idromeno", n� qytetin e Shkodr�s. Sa m� sip�r, n� mb�shtetje t� Ligjit Nr.9154, dat� 6.11.2003 "P�r Arkivat" dhe ligjit Nr. 119/ 2014 "P�r t� drejt�n e informimit", ju vendosim n� dispozicion kopje digjitale t� materialeve arkivore te viteve '80-te shek XX si: • Rilevime t� objekteve dhe rrug�s; • Disa fotografi historike. Sa m� sip�r, mb�shtetur n� ligjin Nr.35/2016 "P�r t� drejtat e autorit dhe t� drejtat e tjera t� lidhura me to", lutemi t� vendoset burimi (Arkivi teknik IKTk), kur t� p�rdoren materialet arkivore. Lidhur me piken 5: Per objektin "Kafja e Madhe" n� Shkod�r disponojm� projekte me t� drejt� autori, te cilat n� mb�shtetje t� Ligjit Nr.35/2016, nuk mund t� vihen n� dispozicion pa aprovimin m� par� t� autorit. Ju informojm� se p�r pikat e tjera t� kerkes�s nuk kemi informacion. https://www.transferxl.com/download/08vnf381Tknxyj https://www.transferxl.com/download/08vW5JLYJgv�Kg	E plot�	Jo
10	02.09.2024	K�rkes� p�r material p�rshkrimor n� lidhje me "Kish�n e Sh�n Mehillit n� lagjen Mangalem , Beart".		N� vijim t� k�rkes�s Suaj n� adres�n elektronike t� IKTk-s�, mb�shtetur n� ligjin Nr.9154, dat� 6.11.2003 "P�r Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "P�r t� drejt�n e informimit", Ju informojme se: N� Arkivin Teknik t� IKTk-s� lidhur me pasurine kulturore "Kisha e Sh�n M�hillit", n� lagjen "Mangalem"	E plot�	Jo

				Berat, nuk disponojme relacione teknike apo materiale përshkimore mbi fazat e ndërhyrjes në këtë objekt, por dokumentacion grafik i viteve '70-të të shek XX-te. Sa me siper, Ju dërgojmë bashkëlidhur në ndihmë të projektit të restaurimit materialet arkivore të kësaj kishe si më poshtë: - Planimetri - Pamje - Prerje Ju informojmë se, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor. https://www.transferxl.com/download/08j59fJzhCZKP7		
11	13.09.2024	Informacion mbi banesën me kod arkivi teknik K 018 , me emërtimin Banesa e Daut Mehmeti , lagjja Kala, Berat, (cdo gjë që përmban dosja, planimetri, skica, rlevime , relacione, foto të vjetra etj).	27.09.2024	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju informojme se: Ne Arkivin Teknik te IKTK-se disponojme dosje teknike dhe dokumentacion fotografik te viteve '70-te shek XX per objektin "Banesa e Daut Mehmeti", me kod K 018, ne lagjen "Kala", Berat si me poshte: - Flete teknike (Planimetri, pamje, prerje) - Projekt restaurimi viti 1973 - Foto historike Per sa me siper, ju dergojme bashkelidhur dokumentat arkivore ne ndihme te punes per te kryer verifikimet per kete monument. Ju informojme se, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur te perdoren dokumentat arkivor. https://www.transferxl.com/it/download/08ZPgsWVZ3cbb	E Plotë	Jo